



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 28.01.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datës 25.01.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik DWH-ALBANIA SH.P.K dhe Operatori Ekonomik DWH-KOSOVA SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Furnizim me paisje te instrumentit GPS dhe Total Station**”, me Nr. të Prok: 632-20-7318-1-2-1, , nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohen si** të pa bazuara kërkesat për ri-shqyrtim të dt. 25.01.2021, të parashtruara nga Operatori Ekonomik DWH-ALBANIA SH.P.K dhe Operatori Ekonomik DWH-KOSOVA SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Furnizim me paisje te instrumentit GPS dhe Total Station**”, me Nr. të Prok: 632-20-7318-1-2-1, kundër **NJOFTIM PËR INFORMATA SHITESË ose PËRMIRËSIM I GABIMIT**, te AK -së, të datës 20.01.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Vërtetohet NJOFTIM PËR INFORMATA SHITESË ose PËRMIRËSIM I GABIMIT, të publikuar me datë: 20.01.2021;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**

Arsyetim

Operatori Ekonomik DWH-ALBANIA SH.P.K dhe Operatori Ekonomik DWH-KOSOVA SH.P.K., me datë 25.01.2021, kanë parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me paisje te instrumentit GPS dhe Total Station**, me Nr. të Prok: 632-20-7318-1-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 28.01.2021, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

I- Përgjigje për DWH ALBANIA:

Anomalia në këto specifika janë pikërisht kërkesat tuaja për rishqyrtim!

Nga fillimi I këtij tenderi e deri më sot (që po bëhen gati 2 vite), ju vazhdoni të përsërisni të njëjtat gabime, pra të bëni lojëra fjalësh me specifikat tona që ne konsiderojmë se janë të rëndësishme për punën tone!

Qëllimi juaj nuk është për të nxjerr në "shtratin ligjor" siç e quani tërë kohën, por thjesht një truk i juaji për t'i ulur specifikat dhe ti dërgoni ato në produkte të dorës së tretë!

Nuk e kuptojmë si dolën këto ankesa tani, kur gjatë tërë kohës kanë qenë po këto specifika aty dhe nuk ka pas ankesë, apo thjeshtë doni që ta zvarrisni procesin në pafundësi!!!?

1. Specifikat e GPS-it kanë qenë të definuara në mënyrën më të mirë të mundshme dhe me ankesat tuaja si këto të fundit të pa kuptimta gjithmonë janë reduktuar! Ne kemi zbatuar vendimet e OSHP-së deri tek vendimin i fundit, dhe duke u ankuar ju duke u ULUR specifikat, pra nuk kemi çka shtojmë dhe çka heqim më shumë, ju e keni kërkuara një garë të hapur dhe ja ku e keni!

Ju rikujtojmë dhe njëherë: Jeni ankuar për Kanalet (janë heq), jeni ankuar për memoriën (është heq), jeni ankuar për IP (është heq), dhe tani shkruani që ka NJE ANOMALI TE PA KUPTIMIT NE SPECIFIKAT E GPS, kjo është qesharake dhe e pa kuptimit!

2. Tastiera: Mbi të gjitha, ti thuash tastierës pjesë periferike e GPS kjo nënkupton që nuk keni të bëni fare me produktet e Gjeodezisë! Ju duhet ta mësoni që tastiera është pjesë përbërës dhe kryesore e GPS, pa tastiere nuk mund të bësh matje, nuk mund të mbihedhësh pika, thjeshtë nuk bënë asnjë punë pa tastier, dhe tani na thuani a është pjesë Periferike apo pjesë Qendrore!?! A e dini Ju që GPS pa tastierë është një produkt që nuk të shërben për asnjë gjë!!!?

3. Këtu futet edhe pjesa e memories: Vazhdoni ta përsërisni e ripërsërisni, mjaft më JU LUTEMI, se nuk ka kuptim një tallje e till me institucionin tonë! Përpara së të bëni një vërejtje lexoni mirë specifikat, askund nuk shkruhet Memorie e Brendshme, POR: HAPSIRE MEMORIEZUESE (RUAJTJA E TE DHENAVE) JO ME E VOGEL SE 4GB, nga doli kjo memorie e brendshme që ju e thuani???, apo thjeshtë një truk tjetër për të bërë konfuz komisionet!!!

4. Lidhur me formatet, ju njoftojmë që DUAM SPECIFIKISHTE ATO FORMATE QE KEMI KERKUAR, formatet e të dhënave janë jetike për punën në gjeodezi, dhe nëse jeni gjeodet minimalishtë këtë duhet ta dini! Të quani formate DWG, CSV si formate sekondare apo terciare kjo dëshmon që nuk e keni iden e punës që ne bëjmë në kadastrë!

Kadastra jonë punon me softuerin CadastralMAP dhe 100% e punëve gjeodezike që gjeodetat dorëzojnë në komunën tone janë në formatet shp. (shape file), CSV dhe DWG! Nuk nuk ka diçka të mesme këtu, këto formate duhen patjetër! Formatet të cilat ju keni cekur nuk janë te aplikueshëm për neve dhe sistemi jonë cadastralMAP është shumë mirë i harmonizuar me formatet CSV, DWG, Shp. Pra, këto formate nuk janë sekondare dhe nuk janë as luks por janë bazike dhe elementare.

5. Tek lapsusi i kërkesës Saktësi jo më e vogël apo saktësi më e madhe: Në këtë pike ulet niveli i diskutimit profesional, gjithsesi do ju sqarojmë edhe për këtë:

Sipas përkufizimit tuaj i bije që ne jemi duke kërkuar saktësi 1.5 mm por jo dhe saktësi 1 mm ose 0.5 mm. Nëse ju vërtet mendoni që fjala "*Saktësi jo më të vogël se 1.5mm*" nënkupton këtë që thamë lartë atëherë këtu kemi të bëjmë me njohuri elementare!

Fjala "*Saktësi jo më të vogël se 1.5 mm*" do të thotë që ne kërkojmë pajisje që ofron saktësinë 1.5 mm minimalisht ose më të mirë, pra 1.5 mm por që për neve është e mirëseardhur edhe nëse paisja është 1 mm.

Ajo që ju pohoni është komentimi i fjalisë "*Saktësi jo më të madhe se 1.5 mm*" sikur ne specifika të ishte kjo fjali atëherë pohimi i juaj do ishte me vend. Nëse thua "*Saktësi jo më të madhe se 1.5 mm*" do të thotë saktësia që ne kërkojmë në vlerën e sajë maksimale të jet 1.5 mm por nëse ju ofroni saktësi 10 m atëherë sipas fjalisë "*Saktësi jo më të madhe se 1.5 mm*" edhe kjo është në rregull.

Si përfundim, ju vejmë në dijeni që nuk do të ndryshohet as edhe një specifik nga ana jonë, sepse këto që kanë mbet janë specifika të domosdoshme për punën tonë dhe nuk do të ulim rendimentin e punës tonë për t'ju plotësuar specifikat e juaja! Ne jemi të vetëdijshëm që produktet Leica që ju përfaqësoni plotësojnë këto specifika por nëse doni të sjellni një prodhim tjetër dhe ai nuk plotëson këto kërkesa atëherë nuk është problemi jonë!

Ju, keni tastierë me Windows, ulet rendimentin "hapet garën" dhe ja ku jemi, tani duhet të presim në çfarë produkti po na vjen nga prodhues të pa dëgjuar më parë!

Ju, ulët kërkesën e memories, pra na dëmtuat nga një produkt që mund ta merrshim me memorie të madhe, "hapet garën" dhe tani ne duhet të presim çfarë produkti me çfarë memorie 128 apo 256 MB po na vjen!

Ju, ulët kërkesën e sinjaleve, "hapet garën" dhe tani ne duhet të rrijm në mëshirë të fatit se çfarë po sjellin OE, cili është më dorë lëshuar për të na ofruar një sinjal më shumë!

Ju, ulet kërkesën e IP-së (mbrojtja nga kushtet e jashtme), nga IP 68 e 67 në IP më të vogël, pra "hapet garën" dhe këtu duke na lënë në mëshirë të fatit se çfarë po na vjen tani! A do të na vijë një GPS, Tastierë apo stacion total me IP më të lartë që I përballon kushtet atmosferike për të na lejuar që ta bëjmë punën tonë!

Tani e fundit filloni dhe mendoni që do të jetë e njëjta gjë dhe tek formatet, pra shkoni aq larg sa që na impononi dhe me çfarë formate të punojmë, shkoni aq lartë sa që Ne duhet të marrim softuera të tretë (konvertues) për ta bërë konvertimin e fileve te punës që ta njohe softueri I Kadastrës!

Nga gjithë këto me sipër, pala e DEMENTUAR është vetëm KADASTRA askush tjetër!

II- Përgjigje për DWH KOSOVA:

Ju lutemi, ku e keni parë ju Memorie e Brendshme??? Është HAPSIRE MEMORIEZUESE (RUAJTJA E TE DHENAVE) JO ME E VOGEL SE 4GB, pra nuk ka të brendshme as të jashtme.

Lidhur me formatet DGW, është një format që po e dëgjojmë për herë të parë! Nëse e keni fjalën për format DWG (AutoCad) atëher duam tju informojmë që Kadastra jonë punon me softuerin CadastralMAP dhe 100% e punëve gjeodezike që gjeodetat dorëzojnë në komunën tone janë në formatet shp. (shape file), CSV dhe DWG! Nuk nuk ka diçka të mesme këtu, këto formate duhen patjetër!

Tek kërkesa Saktësi, nuk është Lapsus! Është Saktësi jo më e vogël, që nënkupton poshtë vlerës së shënuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës